



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 19.10.2020

UDHEZIM I PERGJITHSHEM

MBI

“Hartimin e Rregullores Teknike te Shfrytëzimit, Mirëmbajtjes dhe Kontrollit të objektit dhe nënobjektit të Digave të mëdha”

Rregullorja Teknike e Shfrytëzimit, Mirëmbajtjes dhe Kontrollit të Digave të Mëdha duhet të hartohet duke u bazuar në kërkesat e Ligjit 8681, dt.02.11.2000 “Për Projektimin, Ndërtimin, Operimin dhe Mirembajtjen e Digave”, Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 147, dt. 18.03.2004, “Rregullore per Sigurine e Digave dhe Dambave”, neni 9 dhe 29, Udhezimin Nr. 4, dt.18.07.2003 “Kerkesat e dokumentacionit ligjor dhe teknik qe duhet te permbaje dosja e digave dhe dambave”, Vendimit te KKDM Nr. 3, date 19.10.2020 si dhe Rekomandimet e ICOLD. .

Elementet Kryesore te Digës për te cilen duhet te sherbeje kjo Rregullore jane:

- Trupi i Diges duke perfshire skarpatet, drenazhet, kuroren e diges si dhe elementet e papershkueshmerise se saj sipas tipit dhe llojit te ketyre elementeve
- Sistemi Shkarkimit
- Sistemi i marrjes se Ujit
- Sistemi i devijimit
- Sistemi i zbrazjes

Ne kete rregullore duhet te perfshihen edhe Rregullat per Investigimin e Ujembledhesit te krijuar nga diga dhe e Brigjeve te tij.

Rregullorja teknike e shfrytezimit, monitorimit dhe kontrollit te Objekteve dhe nenobjekteve te Diges duhet te pregatitet nga **Inxhinieri i Diges** dhe te jete e miratuar me shkrim nga Institucioni qe administron Digen ose shfrytezuesi i Diges.

Ne kete Rregullore duhet te shprehen te gjitha detyrat dhe veprimet e **Inxhinierit te Diges** dhe ekipit te sigurise se diges/ njesia teknike e saj ne lidhje me shfrytezimin, mirembajtjen dhe kontrollin e te gjitha objekteve dhe nenobjekteve qe perbejne Digen sipas Nenit 3 te VKM Nr. 147, dt. 18.03.2004

Rregullorja duhet te permbaje te pakten informacionin ne lidhje me:

- 1) **Dosja Teknike/Pasaporta e Diges** e cila duhet te plotesohet sipas Udhezimit te Keshillit te Ministrave, Nr. 4, dt. 18.07.2003 “Kerkesat e dokumentacionit ligjor dhe teknik qe duhet te permbaje dosja e digave dhe dambave” dhe Vendimit te KKDM, Nr. 2, date 21.09.2020.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

2) **Rregulloren e monitorimit te diges** ku te jepen:

- Pershkrim te procesit te monitorimit vizual
- Pershkrim teknik per Sistemet e monitorimit te diges ne se ka (Monitorimi Gjeodezik, Sizmik, Hidroteknik, Gjeologo – Inxhinierik, Hidrometeorologjik, etj) duke dhene edhe tipin dhe numrin e instrumentave te Sistemeve te Monitorimit;
- Grafiku i frekuences se monitorimeve perkatese te permenduar me siper;
- Raportimet e percaktuara sipas legjislacionit ne rastet normale si dhe ne rastet e ngjarjeve te vecanta per Instituconet perkatese nga varen si dhe per KKDM.

3) **Rregulloren per Provat qe duhet te kryhen tek Sistemet e Shkarkimit perpara fillimit te cdo periudhe ujeshume.** Ne kete Rregullore duhet te perfshihen edhe nje informacion i pergjithshem ne lidhje me Manualet e Operimit dhe Mirembajtjes se Pajisjeve elektromekanike te instaluar si dhe te sistemeve te monitorimit.

4) **Rregulloren e shkarkimit te prurjeve te medha per digat qe perdoren per Hidroenergjii dhe furnizim me uje.** Kjo Rregullore duhet te perfshije edhe te dhenat ne lidhje me Nivelet dhe Prurjet maksimale dhe minimale te percaktuara nga Projektuesi si dhe ato te vrojtuar ne 10 vitet e fundit.

5) **Rregulloren e shfrytezimit te ujembledhesit per digat qe perdoren per Ujitje si dhe nivelet maksimale dhe minimale te Ujit tek ujembledhesit ne periudhen ujeshume Tetor – Maj dhe periudhen ujepaket Qershor – Shtator.** Kjo Rregullore duhet te perfshije edhe te dhenat ne lidhje me Nivelet dhe Prurjet maksimale dhe minimale te percaktuara nga Projektuesi si dhe ato te vrojtuar ne 10 vitet e fundit

6) **Te dhenat per Grupin e Sigurise se Diges/ Njesia e drejtimit teknik** i cili duhet te perbehet nga specialiste te fushes ne perputhje me kerkesat e nenit 5 te VKM Nr. 147, dt. 18.03.2003. Ne Rregullore te jepet struktura organizative dhe detyrat perkatese te Grupit/Njesise si edhe te dhenat per Inxhinierin e Diges, personat e kontaktit dhe te komunikimit ne rastet e eventeve qe mund te ndodhin.

7) **Plani i gadishmerise ne raste te emergjencave Civile** duke perfshire edhe sistemin e evakuimit te njerezve dhe ndihmes se shpejte ne raste ngjarjesh te vecanta. Ne kete Plan duhet te jepen edhe te dhenat per Sistemin e Alarmit, sinjalizimit dhe komunikimit ne zone, te dhenat per Planin e rrugeve hyrese ne objektet dhe nenobjektet e Diges te percaktuara me lart si dhe Burimet e furnizimit me energji elektrike ne raste difektesh dhe eventesh te percaktuara ne skenaret e planit te emergjencave

8) **Formularin e Rregjistrimit te Shfrytezimit** i cili te perfshije te dhenat ne lidhje me mbikyrjet, vrojtimet, matjet, perpunimin e te dhenave dhe imterpretimet e tyre. Ne Rregjister duhet te shenohen ne baze mujore ngjarjet gjate shfrytezimit te objektit dhe ujembledhesit, te dhenat e manovrimit te portave, kontrollet ne pjeset e diges, Incidentet qe konstatohen gjate shfrytezimit (filtrimet, rrjedhje ujit, plasaritje, etj), ngjarjet hidrometeorologjike (prurjet dhe nivelet maksimale per cdo muaj), te dhenat per ngjarjet ne lidhje me lekundjet sizmike dhe pasojat e tyre, Punimet e mirembajtjes dhe te riparimit te kryera ne objekt, etj

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI